

Vaksina 4 në 1 dhe vaksina MMR

Informacione për prindërit e fëmijëve tek të rinjtë e vegjël

Vaksina 4 në 1 Cili është emri i vaksinës 4 në 1?

Vaksina 4 në 1 quhet Tetravac.

Cila është vaksina 4 në 1?

4 në 1 është emri që i vendosur vaksinës që ofron mbrojtje kundër difterisë, poliomielitit, tetanozit dhe kollës së mirë (pertusis). Të gjitha këto infeksione janë sëmundje serioze që mund të çojnë në shtrimin në spital dhe në rastin më të keq mund të shkaktojnë vdekje.

Sëmundjet ndaj të cilave ofrohet mbrojtje	Simptomat e zakonshme	Komplikimet e mundshme
Tetanozi	Spazma të dhimbshme muskulore	Konvulsione (kriza) Bllokimi i nofullës Vdekja
Difteria	Dhimbje të fytit Rrahje të shpejta të zemrës	Vështirësi në frymëmarrje Paralizë Insuficiencë kardiake Vdekja
Kolla e mirë (Pertusis)	Kollë irrituese që tingëllon si zhurmë	Vështirësi në frymëmarrje Dështimi i zemrës dhe mushkërive Vdekja
Poliomieliti	Ethe dhimbje koke të vjella	Paralizë Vdekja

Kush ka nevojë për vaksinën 4 në 1?

Fëmijës suaj duhet t'i jenë dhënë vaksina që i mbrojnë nga këto sëmundje në moshën dy, katër dhe gjashtë muajshe si pjesë e vaksinës 6 në 1.

Për të forcuar sistemin imunitar të fëmijës suaj dhe për të siguruar mbrojtje shtesë kundër këtyre sëmundjeve, tek të rinjtë e vegjël kërkohet një dozë tjetër.

A ka fëmijë që nuk duhet ta bëjnë vaksinën 4 në 1?

Ka shumë pak fëmijë që nuk duhet ta bëjnë vaksinën 4 në 1. Fëmija juaj nuk duhet ta bëjë vaksinën nëse ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një vaksine të mëparshme ose ndonjë pjesë të një vaksine apo ka pasur një reaksion të rëndë alergjik ndaj antibiotikëve polimiksinë B, streptomycinë dhe neomicinë.

Ju duhet ta vononi marrjen e vaksinës 4 në 1 nëse fëmija juaj:

- është i sëmurë me temperaturë të lartë.

A ka ndonjë efekt anësor vaksina 4 në 1?

Shumica e fëmijëve nuk kanë asnjë problem pas kësaj vaksine.

Efektet anësore më të zakonshme janë krahuri i lënduar, i skuqur ose i ënjtur. Rrallëherë ënjtja e krahurit mund të jetë nga shpatulla deri te bërryli. Kjo zakonisht ndodh brenda 2 ditëve nga vaksinimi dhe përmirësohet pas 4-5 ditësh. Nuk nevojiten antibiotikë për të trajtuar këtë reaksion lokal. Mund t'i jepni paracetamol ose ibuprofen. Ju gjithashtu duhet t'i jepni shumë lëngje për të pirë. Sigurohuni që fëmija nuk është shumë i ngrohtë dhe që rrobat e tij nuk fërkohen në vendin e injektimit. Më rrallë, fëmijët mund të kenë temperaturë ose dhimbje koke ose të ndihen të sëmurë.

Vaksina MMR Cili është emri i vaksinës MMR?

Emri i vaksinës MMR është Priorix ose MMRVaxPro.

Çfarë është vaksina MMR?

Vaksina MMR ofron mbrojtje kundër fruthit, shytave dhe rubeolës (që quhet edhe fruthi gjerman).

Fruthi, shytat/parotiti dhe rubeola (fruthi gjerman) janë sëmundje shumë infektive që shkaktohen nga viruset.

Ato përhapen kur virusi kalon nga dikush që ka sëmundjen te dikush tjetër që nuk ka mbrojtje kundër saj.

Sëmundjet ndaj të cilave ofrohet mbrojtje	Simptomat e zakonshme	Komplikimet e mundshme
Fruthi	Ethe Skuqje në lëkurë Sy të kuq dhe që dhembin	Encefaliti (ënjtje e trurit) Pneumonia Bronkiti Infeksionet e veshit
Shytat	Gjendra të ënjtura me dhimbje nën nofull dhe temperaturë	Meningjiti Shurdhimi Testikuj të fryrë dhe me dhimbje të meshkujt e rritur
Rubeola (fruthi gjerman)	Ethe dhe skuqje në lëkurë	Nëse një grua shtatzënë sëmuret nga rubeola, fëmija i saj mund të vuajë nga defekte të mëdha në lindje, duke përfshirë verbërinë, dëmtimin e trurit, shurdhimin, probleme me zemrën dhe komplikime të tjera të rënda

Kush ka nevojë për vaksinën MMR?

Fëmijës suaj duhet t'i jetë dhënë vaksina MMR në moshën 12 muajshe. Fëmijët duhet të marrin një dozë të dytë tek të rinjtë e vegjël.

Dy dozat e vaksinës MMR do t'i japin fëmijës tuaj mbrojtjen më të mirë.

Nëse fëmija juaj nuk ka bërë kurrë më parë vaksinën MMR, ai duhet të marrë një dozë të dytë 1 muaj pas dozës së parë.

A ka fëmijë që nuk duhet ta bëjnë vaksinën MMR?

4 in 1 and MMR leaflet Junior Infants Albanian

Ka shumë pak fëmijë që nuk duhet ta bëjnë vaksinën MMR. Fëmija juaj nuk duhet ta bëjë vaksinën nëse ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një vaksine të mëparshme MMR, ndaj ndonjë pjese të vaksinës ose ndaj neomicinës ose xhelatinës që përmban vaksina MMR.

Ju duhet ta vononi marrjen e vaksinës MMR nëse fëmija juaj:

- është i sëmurë me temperaturë të lartë
- është në trajtim në doza të larta të kortikosteroideve
- është duke marrë trajtim të tillë si kimioterapia ose radioterapia
- ka ndonjë sëmundje që ndikon në sistemin e tij imunitar.

A ekziston ndonjë lidhje midis vaksinës MMR dhe autizmit?

Jo. Kërkimet kanë treguar se nuk ka asnjë lidhje midis vaksinës MMR dhe autizmit.

A ka vaksina MMR ndonjë efekt anësor?

Shumica e fëmijëve nuk kanë asnjë problem pas kësaj vaksine. Efektet anësore janë shumë më pak të zakonshme pas një doze të 2-të të vaksinës MMR. Disa fëmijë kanë një vend që i dhemb, ënjtje dhe skuqje në vendin ku është bërë injeksioni. Rrallëherë fëmijët mund të kenë "mini fruth" me skuqje dhe temperaturë 6 deri në 10 ditë më vonë. Fëmijët mund të marrin "mini shytat" me ënjtje në zonën e nofullës në javën e tretë pas vaksinimit. Këto nuk janë ngjitëse. Vaksinat 4 në 1 dhe MMR bëhen në të njëjtën ditë dhe fëmija juaj do të bëjë një vaksinë në çdo krah.

Fëmija juaj duhet të mbrohet nga këto 7 sëmundje infektive kur të fillojë shkollën.

Fëmija juaj tashmë ka bërë vaksina për mbrojtje kundër difterisë, poliomielitit, tetanozit, kollës së mirë, fruthit, shytave dhe rubeolës kur ka qenë foshnjë. Imuniteti ndaj këtyre sëmundjeve zvogëlohet me kalimin e kohës, prandaj për të siguruar mbrojtje shtesë tani rekomandohet një dozë përforcuese.

Sistemi imunitar i fëmijës suaj mund t'i përballojë lehtësisht këto vaksina. Këto vaksina jepen së bashku për t'i dhënë fëmijës tuaj mbrojtjen më të mirë kundër këtyre sëmundjeve.

Si i merrni këto vaksina për fëmijën tuaj?

Këto vaksina ofrohen si pjesë e programit të HSE-së të imunizimit në shkolla. Ju do të merrni detajet dhe një formular pëlqimi përpara se fëmija juaj të vaksinohet.

Në Donegal, Sligo dhe Leitrim këto vaksina bëhen nga mjeku juaj i përgjithshëm. Në këto qarqe, ju do të merrni një letër nga HSE që ju kërkon të shkoni te mjeku i përgjithshëm atëherë kur duhet të bëhen vaksinat.

A mund ta bëjë fëmija ime vaksinën e COVID-19 dhe vaksina të tjera?

Si masë paraprake, për fëmijët e kësaj grupmoshe këshillohet që vaksina e COVID-19 dhe çdo vaksinë tjetër të ndahen me 14 ditë.

Si mund të përgatitet fëmija juaj për ditën e vaksinimit?

Në ditën e vaksinimit, fëmijët duhet:

Të hanë mëngjes

Të veshin një bluzë të lirë me mëngë të shkurtra

Të marrin me vete në shkollë pasaportën e vaksinimit, nëse është e mundur.

Çfarë ndodh nëse fëmija mungon në ditën e vaksinimit në shkollë?

Fëmija juaj mund t'i marrë ende vaksinat. HSE do të organizojë që fëmija juaj të vaksinohet në një klinikë HSE ose mund t'ju kërkohet ta dërgoni fëmijën tuaj te mjeku i përgjithshëm për vaksinim.

Çfarë ndodh nëse fëmija juaj ka nevojë për një dozë të dytë të vaksinës MMR?

HSE do të organizojë vaksinimin e fëmijës suaj.

Informacione të tjera

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi t'i diskutoni ato me një anëtar të ekipit të HSE-së të imunizimit në shkollë, me infermieren tuaj ose me mjekun tuaj të përgjithshëm.

Vizitoni faqen tonë të internetit www.immunisation.ie për të lexuar më shumë informacion rreth këtyre sëmundjeve infektive dhe vaksinave.

Gjithashtu mund të gjeni lidhjet për në broshurat e informimit të pacientit për vaksinat, në faqen e internetit www.hpra.ie. Kërkoni për Tetravac (4 në 1), Priorix ose MMRVaxPro (MMR), për të lexuar broshurën përkatëse të informimit të pacientit.

Formulari i pëlqimit për vaksinat Ju duhet të lexoni dhe të nënshkruani formularin e pëlqimit në këtë paketë dhe ta ktheni atë në shkollë, për t'u siguruar që fëmija juaj të marrë vaksinat në shkollë.